



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.26

27 shkurt

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9871 datë 11.2.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Europiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre”..	1229
Ligj nr.9872 datë 14.2.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar”.....	1240
Ligj nr.9874 datë 14.2.2008	Për ankandin publik	1242

LIGJ
Nr.9871, datë 11.2.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ITALISË, SI SHITESË E KONVENTËS EUROPIANE
PËR EKSTRADIMIN, TË 13 DHJETORIT 1957 DHE E KONVENTËS EUROPIANE PËR
NDIHMË JURIDIKE PËR ÇËSHTJET PENALE, TË 20 PRILLIT 1959, QË KA SI QËLLIM TË
LEHTËSOJË ZBATIMIN E TYRE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Europiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5628, datë 22.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ITALISË, SI SHITESË E
KONVENTËS EUROPIANE MBI EKSTRADIMIN E 13 DHJETORIT 1957 DHE E KONVENTËS
EUROPIANE PËR NDIHMËN JURIDIKE PËR ÇËSHTJET PENALE TË 20 PRILLIT 1959, QË KA SI
QËLLIM TË LEHTËSOJË ZBATIMIN E TYRE**

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Italisë, më poshtë do të quhen Palët Kontraktuese,
dëshirojnë të plotësojnë Konventën Europiane të Ndihmës Juridike për Çështjet Penale të datës 20 prill 1959 në marrëdhëniet ndërmjet Palëve Kontraktuese, dhe të lehtësojnë zbatimin e parimeve që përmbahen në të, pa paragjykuar nenet që mbrojnë lirinë individuale;

duke nënvizuar që është interes i përbashkët i Palëve Kontraktuese që ndihma juridike ndërmjet tyre të kryhet në mënyrë të shpejtë dhe efikase, në përputhje me parimet themelore të së drejtës së tyre të brendshme, si dhe duke respektuar të drejtat individuale dhe parimet e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, e firmosur në Romë, më 4 nëntor 1950;

duke dëshiruar, gjithashtu të plotësojnë Konventën Europiane të Ekstradimit të 13 dhjetorit 1957 në marrëdhëniet ndërmjet Palëve Kontraktuese, duke iu referuar në mënyrë të veçantë ekstradimit të shtetasve respektivë;

duke pasur parasysh që, përsa i përket ekstradimit të shtetasve, Republika e Shqipërisë, në depozitim të instrumentit të ratifikimit të Konventës Europiane për Ekstradimin deklaronte, duke iu referuar parashikimit të bërë në nenin 6 paragrafi 1 të së njëjtës Konventë, që: “Shqipëria refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është Palë Kontraktuese”;

duke njohur që me këtë Marrëveshje, në përputhje me letrën dhe në kuadër të deklarimit të Republikës së Shqipërisë, Palët Kontraktuese kanë si qëllim që të heqin dorë nga e drejta për të refuzuar dorëzimin e shtetasve respektivë, siç parashikohet nga neni 6 paragrafi 1 i Konventës Europiane për Ekstradimin, dhe për këtë qëllim parashikimet e mundshme në kundërshtim me këtë qëllim të parashikuara

nga rregullimet respektive juridike nuk mund të përbëjnë një motiv të vlefshëm për të refuzuar dorëzimin e shtetasve përkatës;

*dëshirojnë të plotësojnë dhe të përfshijnë marrëdhëniet përkatëse në fushën e asistencës juridike për ekstradimin nën dritën dhe në përputhje me *acquis*-in e Bashkimit European në këtë çështje, duke iu referuar në mënyrë të veçantë parashikimeve që përmbahen në Konventën e Ndhmës Juridike në Fushën Penale ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit European, miratuar nga Këshilli i Bashkimit European në 29 maj 2000, si dhe protokollin e saj shtesë, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit European, më 16 tetor 2001;*

duke shprehur besimin e tyre në strukturën dhe në funksionimin e rregullimeve respektive juridike dhe në aftësinë e Palëve Kontraktuese për të garantuar procese të njëjta;

duke njohur se parashikimet e parashikuara nga Konventa Europiane e Ndhmës Juridike në Fushën Penale e 20 prillit 1959 dhe nga Konventa Europiane e Ekstradimit e 13 dhjetorit 1957 qëndrojnë në fuqi për të gjitha çështjet që nuk rregullohen nga kjo Marrëveshje,

kanë rënë dakord për parashikimet e mëposhtme:

TITULLI I RAPORTET ME KONVENTAT E TJERA TË NDIHMËS JURIDIKE DHE EKSTRADIMIT

Neni 1

Raportet me konventat e tjera në fushën e ndihmës juridike dhe ekstradimit

Kjo Marrëveshje ka si qëllim që t'i plotësojë parashikimet dhe të lehtësojë zbatimin ndërmjet Palëve Kontraktuese:

- a) të Konventës Europiane të Ndhmës Juridike në Fushën Penale të 20 prillit 1959, më poshtë e quajtur Konventa Europiane e Ndhmës Juridike;
- b) të protokollit shtesë të Konventës Europiane të Ndhmës Juridike të 17 marsit 1978;
- c) të Konventës Europiane për Ekstradimin e 13 dhjetorit 1957, më poshtë e quajtur Konventa Europiane e Ekstradimit.

TITULLI II PARASHIKIME NË LIDHJE ME KONVENTËN EUROPIANE TË NDIHMËS JURIDIKE

KREU I PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 2

Formalitetet dhe procedurat që kanë të bëjnë me kërkesat për ndihmë juridike

1. Në rastet në të cilat lejohet ndihma, pala së cilës i kërkohet ndihma shikon formalitetet dhe procedurat e treguara në mënyrë të shprehur nga pala kërkuuese, me përjashtim të rasteve kur kjo Marrëveshje parashikon ndryshe dhe gjithmonë nëse formalitetet dhe procedurat e treguara nuk janë në konflikt me parimet themelore të së drejtës së palës që i kërkohet ndihma.

2. Pala që i kërkohet ndihma i jep zbatim sa më shpejt të jetë e mundur kërkesës së ndihmës juridike, duke pasur plotësisht parasysh, brenda kufijve të mundshëm, afatet procedurale, si dhe afatet e tjera të treguara nga pala kërkuuese. Pala kërkuuese shpjegon arsyet se përse ka kërkuar një afat të caktuar.

3. Në rast se kërkesës nuk mund t'i jepet zbatim, tërësisht ose pjesërisht, sipas kërkesave të përcaktuara nga pala kërkuuese, autoritetet e palës që i kërkohet ndihma informojnë menjëherë autoritetet e palës kërkuuese, duke treguar kushtet sipas të cilave mund t'i jepet zbatim kërkesës. Autoritetet e palës kërkuuese dhe të palës që i kërkohet ndihma mund të bien dakord më pas mbi të ardhmen që i rezervohet kërkesës, mbi domosdoshmërinë duke e kushtëzuar këtë me plotësimin e këtyre kushteve.

4. Nëse parashikohet se afatet e përcaktuara nga pala kërkuuese për t'i dhënë zbatim kërkesës nuk mund të respektohen dhe, nëse arsyet sipas paragrafit 2, fraza e dytë, tregojnë konkretisht që një vonesë e mundshme do të përbëjë një pengesë themelore për procedimin në vazhdim të palës kërkuuese, autoritetet e palës që i kërkohet ndihma tregojnë menjëherë një përllogaritje të afateve të nevojshme për t'i dhënë

zbatim kërkesës. Autoritetet e palës kërkuese komunikojnë menjëherë, nëse kërkesa gjithsesi duhet të merret parasysh. Autoritetet e palës kërkuese dhe të palës që i kërkohet ndihma mund të bien dakord më pas mbi të ardhmen që duhet t'i rezervohet kërkesës.

Neni 3

Dërgimi nëpërmjet postës dhe dorëzimi i akteve të procedimit

1. Secila Palë Kontraktuese i dërgon personave që ndodhen në territorin e tjetrës aktet e procedimit të destinuara për to drejtpërdrejt nëpërmjet postës.

2. Dërgimi i akteve të procedimit mund të bëhet nëpërmjet autoriteteve kompetente qendrore të palës që i kërkohet ndihma vetëm në rast se:

- a) adresa e marrësit të aktit është e panjohur ose e paqartë; ose
- b) normat përkatëse të procedurës së palës kërkuese kërkojnë një provë të dorëzimit të kryer të aktit të marrësi, e ndryshme nga ajo që mund të sigurohet nëpërmjet postës; ose
- c) nuk ka qenë e mundur që të dërgohet akti nëpërmjet postës; ose
- d) pala kërkuese ka motive të bazuara për të pretenduar se dërgimi nëpërmjet postës është joefikas dhe i papërshtatshëm.

3. Nëse ka motiv për të pretenduar që marrësi nuk kupton gjuhën në të cilën është hartuar akti i procedimit, ky i fundit, ose të paktën pjesët e rëndësishme të tij, duhet të përkthehen në gjuhën ose në një nga gjuhët e palës në territorin e të cilës gjendet marrësi. Nëse autoriteti që nxjerr aktin është në dijeni të faktit që marrësi njeh vetëm një gjuhë tjetër, akti ose të paktën pjesët e rëndësishme të tij duhet të përkthehen në këtë gjuhë tjetër.

4. Të gjitha aktet e procedimit janë të pajisura me një njoftim në të cilën është përcaktuar që marrësi mund të marrë informacione nga autoriteti që ka nxjerrë aktin ose nga autoritete të tjera të palës së interesuar në lidhje me të drejtat e tij dhe detyrimet e tij në lidhje me aktin. Paragrafi 3 zbatohet në mënyrë të njëjtë me këtë njoftim.

5. Ky nen nuk ndikon në zbatimin e neneve 8, 9 dhe 12 të Konventës Europiane të Ndhmës Juridike.

Neni 4

Transmetimi i kërkesave të ndihmës juridike

1. Kërkesat për ndihmë juridike bëhen në mënyrë të shkruar ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të aftë për të prodhuar një regjistrim të shkruar të kushteve që i bëjnë të mundur palës që i kërkohet ndihma të verifikojë vërtetësinë. Këto kërkesa kryhen drejtpërdrejt nëpërmjet autoriteteve gjyqësore që kanë kompetencë territoriale me qëllim të prezantimit të tyre dhe sipas përmbajtjes, përpara zbatimit të tyre, i transmetohen:

- përsa i përket Republikës Italiane, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Drejtësisë Penale, zyra II;
- përsa i përket Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme për Çështjet e Drejtësisë.

Kërkesat për ndihmë juridike rikthehen nëpërmjet kanaleve të njëjta, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë nen. Çdo denoncim i një Pale të drejtpërdrejtë për të siguruar që të nxiten procedimet përpara gjyqtarëve të tjetrës në kuadër të nenit 21 të Konventës Europiane të Ndhmës Juridike mund të jetë objekt i komunikimeve të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve juridike kompetente.

2. Paragrafi 1 nuk paragjykon mundësinë që të dërgohen ose të dorëzohen kërkesat në çështje specifike:

- a) nëpërmjet një autoriteti qendror të njëjës palë dhe të një autoriteti qendror të tjetrës; ose
- b) midis një autoriteti gjyqësor të njëjës palë dhe një autoriteti qendror të tjetrës.

3. Aty ku, përsa i përket kërkesave sipas neneve 9, 10 ose 11, autoriteti kompetent është një autoritet gjyqësor ose një autoritet qendror për njëjën palë dhe një autoritet doganor ose policor për palën tjetër, kërkesat dhe përgjigjet mund të shkëmbehen drejtpërdrejt midis këtyre autoriteteve. Paragrafi 1 zbatohet për këto kontakte.

4. Kërkesat ose komunikimet më poshtë dërgohen nëpërmjet autoriteteve qendrore të palëve:

a) kërkesat për transferim të përkohshëm ose tranziti të personave të burgosur sipas nenit 11 të Konventës Europiane të Ndihmës Juridike;

b) njoftime të informacioneve në lidhje me dënimet sipas nenit 22 të Konventës Europiane të Asistencës Juridike. Gjithsesi, kërkesat për kopje të vendimeve dhe të masave sipas nenit 4 të protokollit shtesë të Konventës Europiane të Ndihmës Juridike mund t'u dërgohen drejtpërdrejt autoriteteve kompetente.

Neni 5

Shkëmbimi spontan i informacioneve

1. Brenda kufijve që vendos e drejta e brendshme, autoritetet gjyqësore kompetente të Palëve Kontraktuese mund të procedojnë për një shkëmbim informacioni, pa qenë paraqitur një kërkesë për këtë qëllim, në lidhje me vepra penale që ndiqen nga ana e autoritetit marrës në momentin e transmetimit të informacioneve.

2. Informacionet shkëmbehen në mënyrë të shkruar, ose nëpërmjet çdo mjeti të aftë për të prodhuar një regjistrim të shkruar, me kushtet që i lejojnë Palëve Kontraktuese që të verifikojnë vërtetësinë.

3. Autoriteti që siguron informacionet mund, sipas së drejtës së brendshme, t'i imponojë autoritetit gjyqësor marrës kushte për përdorimin e këtij informacioni. Autoriteti gjyqësor marrës i respekton këto kushte.

4. Midis autoriteteve gjyqësore kompetente të parashikuara nga paragrafi 1, për palën italiane, Drejtoria Kombëtare Antimafia procedon me shkëmbimin e informacioneve dhe të aktiviteteve të tjera të dhëna asaj nga e drejta e brendshme e vendit.

KREU II

KËRKESA E FORMAVE TË VEÇANTA TË NDIHMËS JURIDIKE

Neni 6

Kthimi

1. Palës që i kërkohet ndihmë, sipas kërkesës së palës kërkuese dhe pas mbrojtjes së të drejtave të të tretëve në mirëbesim, mund të vërë në dispozicion të palës kërkuese, me qëllim të rikthimit të pronari i ligjshëm, të mirat e siguruar nëpërmjet veprave penale.

2. Në zbatim të neneve 3 dhe 6 të Konventës Europiane të Ndihmës Juridike, pala që i kërkohet ndihmë mund të heqë dorë nga rikthimi i të mirave para ose pas dorëzimit të tyre te pala kërkuese, në rast se kjo mund të favorizojë rikthimin e këtyre të mirave te pronari i ligjshëm. Mbeten të paparagjykuara të drejtat e të tretëve në mirëbesim.

3. Në rast të heqjes dorë nga rikthimi i të mirave para dorëzimit të tyre te pala kërkuese, pala që i kërkohet ndihmë nuk kërkon asnjë të drejtë garancie ose asnjë të drejtë tjetër kundërshtimi në lidhje me parashikimet e ligjit për çështjet e taksave dhe të doganës në lidhje me këto të mira. Një heqje dorë që sipas paragrafit 2 nuk paragjykon të drejtën e palës që i kërkohet ndihmë të përfitojë detyrime ose të drejta nga pronari i ligjshëm.

Neni 7

Pyetja nëpërmjet lidhjes audiovizive

1. Nëse një person ndodhet në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese, dhe duhet të pyetet në cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit nga organet gjyqësore të palës tjetër, kjo e fundit mund të kërkojë që nëse për personin në fjalë nuk është e përshtatshme apo e mundur të shfaqet vetë në territorin e saj, që pyetja të zhvillohet nëpërmjet lidhjes audiovizive, sipas dispozitave të paragrafëve 2 dhe 8.

2. Pala të cilës i kërkohet ndihmë jep pëlqimin për një pyetje të tillë nëse metoda e lidhjes audiovizive nuk përbën shkelje të parimeve themelore të së drejtës së brendshme dhe me kusht që të disponojë instrumente teknike për kryerjen e një dëgjimi të tillë në distancë. Nëse pala të cilës i kërkohet ndihmë nuk disponon instrumentet teknike për kryerjen e lidhjes audiovizive, ato mund t'i vihen në dispozicion nga pala kërkuese në vijim të një marrëveshjeje të ndërsjellë.

3. Kërkesat e pyetjes me anë të lidhjes audiovizive, përveç informacioneve për të cilat flet neni 14 i Konventës Europiane të Ndihmës në Fushën Juridike përbajnë tregues

të arsyeve për të cilat nuk është e përshtatshme apo e mundur prania e dëshmitarit apo e ekspertit, emrin e organit gjyqësor dhe të personave që do të kryejnë pyetjen.

4. Organi gjyqësor i palës së pyetur urdhëron paraqitjen e personit në fjalë sipas formave të parashikuara nga legjislacioni i tij.

5. Në pyetjen e kryer nëpërmjet lidhjes audiovizive zbatohen dispozitat në vijim:

a) gjatë pyetjes është i pranishëm autoriteti gjyqësor i palës së pyetur, i asistuar dhe nga një përkthyes nëse është e nevojshme, që kujdeset dhe garanton identifikimin e personit që do të pyetet, si dhe respektimin e parimeve themelore të së drejtës së palës së pyetur. Nëse autoriteti gjyqësor i palës së cilës i kërkohet ndihmë konsideron se gjatë pyetjes dhunohen parimet themelore të së drejtës së kësaj pale, ajo ndërmerr pa vonesë masat e nevojshme për të siguruar që pyetja të vazhdojë të kryhet sipas këtyre parimeve;

b) organet kompetente të palës së pyetur bien dakord, nëse është rasti, për ndërmarrjen e masave mbrojtëse për personin që do të pyetet;

c) pyetja drejtohet drejtpërdrejt nga organi gjyqësor i palës kërkuese ose nën drejtimin e tij, në përputhje me parimet e tij të së drejtës;

d) pas kërkesës së palës kërkuese, ose të personit që do të pyetet, pala së cilës i kërkohet ndihmë sigurohet që personi që do të pyetet të asistohet, nëse është rasti, nga një përkthyes;

e) personi që do të pyetet mund të përdorë të drejtën e tij për të mos u përgjigjur, të parashikuar nga legjislacioni i brendshëm i palës së cilës i kërkohet ndihmë, apo i palës kërkuese.

6. Përveç masave të vendosura për mbrojtjen e personave, në përfundim të pyetjes autoriteti gjyqësor i palës së cilës i kërkohet ndihmë përgatit një procesverbal duke shënuar datën dhe vendin e pyetjes, identitetin e personit të pyetur, identitetet dhe cilësitë e të gjithë personave të tjerë që kanë marrë pjesë në marrjen në pyetje, paraqitjet e mundshme të betimeve të bëra dhe kushtet teknike në të cilat është zhvilluar pyetja.

Ky dokument u dërgohet nga autoritetet kompetente të palës së cilës i kërkohet ndihmë, autoriteteve kompetente të palës kërkuese.

7. Kostot për vendosjen e lidhjes me video, organizimin e lidhjes me video të pala së cilës i kërkohet ndihmë, pagesa e përkthyesve të ofruar prej kësaj pale, përputhjen e pagesave të dëshmitarëve dhe të ekspertëve, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tyre të udhëtimit për të arritur në palën së cilës i kërkohet ndihmë, rimbursohen nga pala kërkuese drejt palës së cilës i kërkohet ndihmë, përveç rastit kur kjo e fundit heq dorë plotësisht apo pjesërisht nga rimbursimi.

8. Palët Kontraktuese adoptojnë masat e nevojshme për të siguruar që në pyetjen e dëshmitarëve ose të ekspertëve të kryera në territorin e tyre, në bazë të këtij neni, në rastin kur ata refuzojnë të dëshmojnë megjithëse e kanë detyrim apo japin dëshmi të rreme, të aplikohet e drejta e brendshme me të njëjtën vlerë si në marrjet në pyetje të kryera në një procedim brenda vendit.

9. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe në marrjen në pyetje të të pandehurve, si dhe të subjekteve të tjera dhe palëve të procedimit. Në këtë rast, vendimi për të kryer lidhjen audiovizive, si dhe kushtet në të cilat ajo kryhet, përcaktohen nga Palët Kontraktuese, në përputhje me të drejtën e tyre kombëtare dhe instrumentet përkatëse ndërkombëtare ekzistuese, përfshirë Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore të 1950. Për sa janë të pajtueshme, zbatohen dispozitat e parashikuara nga paragrafët 2 dhe 8.

Neni 8

Pyetja e dëshmitarëve dhe e ekspertëve me anë të lidhjes tefonike

1. Kur nuk është e mundur të procedohet me një lidhje audiovizive, nëse një person ndodhet në territorin e njëres prej Palëve Kontraktuese dhe duhet të pyetet nga organet gjyqësore të palës tjetër në cilësinë e dëshmitarit ose të ekspertit, pala e dytë mund të kërkojë ndihmën e palës së parë në mënyrë që pyetja të kryhet nëpërmjet telefonit, në zbatim të paragrafëve nga 2 deri në 6.

2. Kusht paraprak për kryerjen e pyetjes nëpërmjet telefonit është që dëshmitari ose eksperti të jenë dakord.

3. Pala së cilës i kërkohet ndihmë bie dakord me pyetjen nëpërmjet telefonit, nëse përdorimi i kësaj teknike nuk bie në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës së brendshme.

4. Kërkesa për pyetjen nëpërmjet telefonit përmban përveç informacioneve që përmban neni 14 i Konventës Europiane të Ndhmës Juridike emrin e autoritetit gjyqësor dhe të personave që do të kryejnë pyetjen, si dhe të dhëna nga të cilat të rezultojë që dëshmitari ose eksperti janë dakord të marrin pjesë në

një marrje në pyetje nëpërmjet telefonit.

5. Aspektet praktike të pyetjes përcaktohen nga Palët Kontraktuese. Gjatë rënies dakord mbi aspektet e lartpërmendura, pala së cilës i kërkohet ndihmë impenjohet që të:

a) njoftojë dëshmitarin ose ekspertin në fjalë për orën dhe vendin e pyetjes;

b) të kryejë identifikimin e dëshmitarit ose ekspertit;

c) të verifikojë që dëshmitari ose eksperti janë dakord për kryerjen e pyetjes nëpërmjet telefonit.

6. Zbatohen dispozitat e përshtatshme, siç janë neni 7, paragrafi 5 dhe paragrafi 8. Përveçse kur është vendosur ndryshe, zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat e nenit 7, paragrafi 7.

Neni 9

Dorëzimet e kontrolluara

1. Palët Kontraktuese zotohen që të garantojnë se me marrjen e kërkesës nga pala tjetër mund të zhvillojnë dorëzime të kontrolluara në territorin ku zhvillohen hetimet lidhur me vepra penale objekt ekstradimi.

2. Vendimi për të kryer dorëzime të kontrolluara merret në secilin rast specifik, nga autoritetet kompetente të palës së cilës i kërkohet ndihmë, duke respektuar të drejtën e brendshme të kësaj pale.

3. Dorëzimet e kontrolluara kryhen në përputhje me procedurat në fuqi të palës së cilës i kërkohet ndihmë. Autoritetet kompetente të kësaj pale mbajnë të drejtën e iniciativës, drejtimin dhe kontrollin e operacionit.

Neni 10

Skuadrat e përbashkëta hetimore

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të krijojnë me marrëveshje të përbashkët, një skuadër të përbashkët hetimore, për një qëllim të caktuar dhe një afat të kufizuar, i cili mund të zgjatet me aprovimin e Palëve Kontraktuese, për të kryer hetime të një natyre penale, në territorin e palëve. Përbërja e skuadrës tregohet në marrëveshje.

Një skuadër e përbashkët hetimore mund të ngrihet në veçanti kur:

a) hetimet e kryera nga një prej Palëve Kontraktuese mbi vepra penale, janë të një natyre komplekse dhe të vështira që kanë lidhje me Palën tjetër Kontraktuese;

b) kur Palët Kontraktuese kryejnë hetime mbi vepra penale që për shkak të rrethanave të rastit kërkojnë ndërmarrjen e një veprimi të koordinuar dhe për të cilin është rënë dakord. Një kërkesë për ngritjen e një skuadre të përbashkët hetimore mund të paraqitet nga të dyja Palët Kontraktuese të interesuara. Skuadra ngrihet në Palën Kontraktuese ku do të presupozohet se do të zhvillohen hetimet.

2. Përveç informacioneve të parashikuara nga neni 14 i Konventës Europiane të Ndhmës Juridike, kërkesat për ngritjen e një skuadre të përbashkët hetimore përmbajnë propozime lidhur me përbërjen e skuadrës.

3. Skuadra e përbashkët hetimore vepron në territorin e Palëve Kontraktuese sipas kushteve të përgjithshme në vijim:

a) skuadra drejtohet nga një përfaqësues i organeve kompetente dhe merr pjesë në hetimet e natyrës penale të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës vepron skuadra. Drejtuesi i skuadrës vepron brenda kufijve të kompetencave të tij në përputhje me të drejtën e brendshme të palës;

b) skuadra vepron në përputhje me të drejtën e Palës Kontraktuese në të cilën vepron. Gjatë kryerjes së funksioneve të tyre anëtarët e skuadrës i raportojnë personit të parashikuar në germën “a”, duke pasur parasysh kushtet e vendosura nga autoritetet përkatëse në marrëveshjen e krijimit të skuadrës;

c) Pala Kontraktuese në territorin e të cilës vepron skuadra, cakton kushtet e nevojshme organizative për t’i mundësuar funksionimin.

4. Në kuptim të këtij neni me shprehjen “të caktuar” pranë skuadrës hetimore nënkuptohen anëtarët e skuadrës së përbashkët hetimore, të ndryshëm nga ata të Palës Kontraktuese në territorin e të cilës ajo vepron.

5. Anëtarët e caktuar të skuadrës së përbashkët hetimore janë të autorizuar të jenë të pranishëm në territorin e Palës Kontraktuese ku do të veprohet nëse janë ndërmarrë masa hetimore. Gjithsesi, për arsye të veçanta, drejtuesi i skuadrës mund të urdhërojë ndryshe, në përputhje me të drejtën e Palës Kontraktuese në të cilën vepron skuadra.

6. Anëtarëve të caktuar të skuadrës së përbashkët hetimore, në përputhje me të drejtën e Palës Kontraktuese të veprimit, mund t'u ngarkohet ekzekutimi i këtyre masave hetimore nga ana e drejtuesit të skuadrës, atëherë kur kjo është aprovuar nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese të ndërhyrjes, dhe nga Pala Kontraktuese që i ka caktuar.

7. Nëse skuadra e përbashkët hetimore sheh nevojën që në njërin nga Palët Kontraktuese të merren masa hetimore, personat e caktuar nga kjo Palë Kontraktuese mund të bëjnë direkt një kërkesë drejtuar organeve kompetente të tyre. Masat në fjalë ekzaminohen nga kjo Palë Kontraktuese lidhur me kushtet në të cilat do të zbatoheshin, nëse do të ishin kërkuar në kuadër të një hetimi të kryer në nivel kombëtar.

8. Nëse skuadra e përbashkët hetimore ka nevojë për ndihmën e një shteti që nuk ka marrë pjesë në ngritjen e skuadrës, organet kompetente të Palës Kontraktuese të ndërhyrjes mund të drejtojnë një kërkesë tek organet kompetente të shtetit tjetër të interesuar në përputhje me instrumentet dhe dispozitat ekzistuese.

9. Për qëllimet e një hetimi penal të kryer nga skuadra e përbashkët hetimore, anëtarët e kësaj të fundit mund t'i ofrojnë kësaj skuadre informacionet që disponojnë të ardhura nga Pala Kontraktuese që i ka shkëputur, por duke respektuar të drejtën e tyre të brendshme dhe brenda kufijve të kompetencave përkatëse.

10. Informacionet e marra në mënyrë të ligjshme nga një anëtar apo nga një pjesëtar i shkëputur gjatë pjesëmarrjes në një skuadër të përbashkët hetimore, dhe të cilat ndryshe nuk janë në dispozicion të organeve kompetente të Palës Kontraktuese të interesuar, mund të përdoren:

a) për arritjen e qëllimeve të parashikuara në dokumentin e krijimit të skuadrës;

b) për të pasur konsensusin e Palës Kontraktuese ku vihen në dispozicion informacionet për identifikimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave të tjera penale. Ky konsensus mund të mohohet vetëm atëherë kur çështja në fjalë mund të verë në rrezik hetimet penale të Palës Kontraktuese të interesuar ose atëherë kur kjo e fundit mund të refuzojë asistencën juridike të përdorur për këtë qëllim;

c) për të eliminuar një kërcënim të menjëhershëm dhe të rëndë ndaj sigurisë publike, duke mos e dëmtuar germën "b" në rastin kur do të nisët një hetim penal i mëtejshëm;

d) për qëllime të tjera brenda kufijve për të cilat është rënë dakord nga Palët Kontraktuese që janë pjesë përbërëse e skuadrës.

11. Neni në fjalë nuk prek asnjë nga dispozitat e tjera në fuqi apo marrëveshje lidhur me krijimin, apo veprimtarinë e skudrave të përbashkëta hetimore.

Neni 11

Infiltrimet

1. Palët Kontraktuese mund të bien dakord të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për zhvillimin e hetimeve në fushën e kriminalitetit, me anë të personave të infiltruar ose nën identitete të rreme (infiltrimet).

2. Vendimi mbi kërkesën merret në secilin rast specifik nga autoritet kompetente të palës së pyetur në përputhje me të drejtën dhe procedurat në nivel kombëtar. Kohëzgjatja e operacionit të infiltrimit, kushtet e posaçme dhe statusi ligjor i agjentëve të përfshirë gjatë operacionit të infiltrimit caktohen nga palët në respektim të të drejtës së tyre dhe të procedurave të tyre të brendshme.

3. Operacionet e infiltrimit kryhen në përputhje me të drejtën dhe procedurat e brendshme të Palëve Kontraktuese në territorin e të cilës zhvillohet operacioni. Palët Kontraktuese bashkëpunojnë për të kryer përgatitjen dhe kontrollin e operacionit të infiltrimit dhe për të ndërmarrë vendime me qëllim garantimin e sigurisë së agjentëve të infiltruar apo nën identitetet falco.

Neni 12

Përgjegjësia penale në lidhje me funksionarët

Gjatë zhvillimit të operacioneve për të cilat flasin nenet 9, 10 e 11, funksionarët e palës së kundërt nga pala në të cilën zhvillohet operacioni njësohen me funksionarët e kësaj të fundit, përsa i përket veprave penale kundër tyre, apo të kryera nga ata.

Neni 13

Përgjegjësia civile në lidhje me funksionarët

1. Kur në përputhje me nenet 9, 10 e 11, funksionarët e njëres Palë Kontraktuese veprojnë te tjetra, e para është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara nga ajo në përmbushjen e misionit, konform të drejtës së

Palës Kontraktuese në territorin në të cilën ata veprojnë.

2. Pala në territorin e së cilës janë shkaktuar dëme të parashikuara nga paragrafi 1, kryen riparimin e dëmeve sipas kushteve që ekzistojnë për dëmet e shkaktuara nga funksionarët e saj.

3. Pala Kontraktuese, funksionarët e së cilës i kanë shkaktuar dëme të tretëve në territorin e palës tjetër, i kthen në mënyrë të plotë shumat e derdhura kësaj pale, viktimave apo familjarëve të tyre.

4. Përveç ushtrimit të të drejtave të tyre kundrejt të tretëve dhe përveç paragrafit 3, secila Palë Kontraktuese, në rastin e paragrafit 1 heq dorë nga kërkesa drejtuar tjetrës palë mbi dëmshpërblimin e dëmit të pësuar nga ajo.

Neni 14

Kërkesa e informacioneve mbi llogaritë bankare dhe mbi operacionet bankare

1. Sipas kërkesave të këtij neni, secila Palë Kontraktuese adopton dispozitat e nevojshme për të përcaktuar në përgjigje të një kërkesë të transmetuar nga pala tjetër, nëse një person fizik apo juridik, objekt i një hetimi penal, ka ose kontrollon një apo më shumë llogari bankare, të çfarëdolloj natyre, pranë një institucioni bankar që ndodhet në territorin e saj, dhe në rast se është kështu, të japë çdo lloj informacioni specifik mbi llogaritë e gjetura.

Informacionet përfshijnë edhe faktin nëse ka ardhur ndonjë kërkesë dhe nëse jepen brenda një periudhe të arsyeshme, edhe llogaritë e hapura nga personi, objekt i procedimit.

2. Detyrimi i parashikuar nga ky nen zbatohet vetëm në masën brenda së cilës detajet në fjalë njihen nga organizmi financiar pranë të cilit është depozituar llogaria.

3. Detyrimi i parashikuar nga ky nen zbatohet vetëm nëse hetimi ka të bëjë me një vepër penale që ndëshkohet me kufizim lirie, me një maksimum prej të paktën katër vjetësh në palën kërkuese, dhe me të paktën dy vjet në palën e pyetur.

4. Në kërkesë, autoriteti kërkuar:

a) tregon arsyet përse konsideron se informacionet e kërkuara janë të një rëndësie themelore për arritjen e qëllimeve të hetimit të veprës penale;

b) tregon mbi ç'arsye prezumon se llogaritë bankare mbahen pranë bankave të ndodhura në palën e pyetur, dhe prej sa kohësh është në dijeni të këtij fakti, cilat banka mund të jenë të përfshira;

c) jep çfarëdolloj informacioni që disponon dhe që mund të lehtësojë zbatimin e kërkesës.

5. Pas marrjes së kërkesës nga pala kërkuese, pala e pyetur ofron detajet e llogarive bankare mbi të cilat kërkohet informacion, dhe mbi veprimet bankare që janë kryer brenda një periudhe të caktuar, mbi një apo më shumë llogari të përcaktuara në kërkesë, përfshirë këtu edhe detajet e lidhura me llogari të mundshme emetuese (dhënëse) apo përfituese.

6. Detyrimi i parashikuar në paragrafin e mëparshëm zbatohet vetëm në masën brenda së cilës detajet në fjalë janë të njohura nga organizmi financiar pranë të cilit është depozituar llogaria.

7. Pala kërkuese shpjegon në kërkesën e saj arsyet pse konsideron se informacionet e kërkuara janë të dobishme për qëllimet e hetimeve mbi veprën penale.

8. Për ekzekutimin e një kërkesë të parashikuar nga ky nen, Palët Kontraktuese mund të zbatojnë të njëjtat kushte që zbatojnë edhe për kërkesat e kontrolleve dhe sekuestrimeve.

Neni 15

Kërkesat për verifikimin e veprimeve bankare

1. Secila Palë Kontraktuese merr përsipër që, pas marrjes së një kërkesë, të jetë në gjendje të ushtrojë kontroll, gjatë një periudhe të caktuar mbi veprimet bankare që janë kryer në një apo më shumë llogari bankare të përcaktuara në kërkesë, dhe t'i japë rezultatet përkatëse palës kërkuese.

2. Pala kërkuese tregon në kërkesën e saj arsyet përse i konsideron se informacionet e kërkuara janë të domosdoshme për hetimin e veprës penale në fjalë.

3. Vendimi për të ushtruar kontroll merret në secilin rast specifik nga organet kompetente të palës së pyetur, duke mbajtur në konsideratë dispozitat e së drejtës së saj të brendshme.

4. Mënyrat praktike të kontrollit koordinohen me organet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Neni 16
Konfidencialiteti

Palët Kontraktuese adoptojnë masat e nevojshme për të siguruar që bankat nuk do t'u zbulojnë klientëve të interesuar apo palëve të treta faktin që është kryer një transmetim informacionesh në përputhje me dispozitat e neneve 14 dhe 15, apo që është duke u zhvilluar një hetim.

Neni 17
Sekreti bankar

Palët Kontraktuese nuk e përdorin sekretin bankar si arsye për të refuzuar bashkëpunimin pas marrjes së një kërkesë për ndihmë juridike në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje.

TITULLI III
DISPOZITA LIDHUR ME EKSTRADIMIN E SHTETASVE

Neni 18
Ekstradimet e shtetasve

1. Palët Kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale, ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Europiane mbi Ekstradimin.

2. Palët Kontraktuese nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit.

3. Kërkesat për ekstradimin bëhen drejtpërdrejt midis autoriteteve qendrore: për Republikën e Italisë nga Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë Penale, zyra II, pranë Ministrisë së Drejtësisë; për Republikën e Shqipërisë nga Ministria e Drejtësisë Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë.

TITULLI IV
DISPOZITA LIDHUR ME TRANSFERIMET E PROCEDIMEVE PENALE

Neni 19
Transferimet e procedimeve penale

Palët Kontraktuese marrin përsipër të rregullojnë transferimin e procedimeve penale mbi bazën e Konventës mbi Transferimet e Procedimeve Penale, hapur për firmë në Strasburg, më 15 maj 1972.

TITULLI V
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 20
Parime të përgjithshme

1. Përsa i përket trajtimit të të dhënave personale që do të transmetohen nga Palët Kontraktuese në bazë të kësaj Marrëveshjeje, palët kontraktuese garantojnë se dispozitat përkatëse të së drejtës së brendshme ofrojnë një nivel mbrojtjeje të dhënash i cili është i barabartë të paktën me nivelin e kërkuar nga Konventa e Këshillit të Europës, e 28 janarit 1981, mbi mbrojtjen e personave në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave me karakter personal.

2. Në çdo rast kjo Marrëveshje nuk paragjykon detyrimet e caktuara në ngarkim të shteteve Palë Kontraktuese lidhur me marrëveshje të tjera shumëpalëshe ekzistuese apo të ardhshme, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, përfshirë këtu edhe instrumentet e adoptuar nga Bashkimi Europian në

fuqi, në nenin 34 paragrafi 2 i Traktatit Themelues të BE-së.

Neni 21

Trajtimi i të dhënave personale

1. Përveç sa është parashikuar nga neni 22, të dhënat personale të transmetuara mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje mund të përdoren nga Pala Kontraktuese tek e cila janë transferuar:

- a) për llogari të procedimeve mbi të cilat zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;
- b) për procedime të tjera gjyqësore dhe administrative të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me procedimet e germës “a”;
- c) për parandalimin e një rreziku imediat dhe të rëndë për sigurinë publike;
- ç) për çfarëdolloj qëllimi tjetër, vetëm pas marrjes së autorizimit nga Pala Kontraktuese që transmeton të dhënat, përveç rastit kur pala e interesuar ka marrë aprovimin e personit të interesuar.

2. Ky nen gjen zbatim edhe për të dhënat personale që nuk janë transmetuar, por që janë mbajtur me mënyra të ndryshme në zbatim nga kjo Marrëveshje.

3. Në varësi të rrethanave të rastit specifik, Pala Kontraktuese që transmeton të dhënat mund t'i kërkojë Palës Kontraktuese tek e cila të dhënat kanë qenë transferuar, të japë informacione mbi përdorimin e të dhënave.

4. Ky nen nuk gjen zbatim për të dhëna personale të përfituara nga njëra prej Palëve Kontraktuese në kuptim të kësaj Marrëveshjeje, dhe të ardhura nga kjo palë.

Neni 22

Mbrojtja e të dhënave në fushën e shkëmbimit të informacioneve

1. Në aktin e shkëmbimit të informacioneve, në çdo rast, organet kompetente gjyqësore marrin në konsideratë kërkesat për mbrojtjen e të dhënave me karakter personal. Këto respektojnë dispozitat në fuqi të Konventës së Këshillit të Europës, të datës 28 janar 1981, mbi mbrojtjen e personave lidhur me përpunimin automatik të të dhënave me karakter personal. Me qëllimin e mbrojtjes së të dhënave, organet gjyqësore kompetente, në zbatim të dispozitës së paragrafit 2, mund të vendosin kushte për trajtimin e të dhënave me karakter personal nga ana e Palës Kontraktuese tek e cila këto të dhëna janë transmetuar.

2. Kur në zbatim të kësaj Marrëveshjeje transmetohen të dhëna me karakter personal, aplikohen dispozitat në vijim:

a) Trajtimi i të dhënave personale nga ana e organit marrës, pranohet vetëm kur është për arsyet e paraqitura në nenin 5. Ky organ mund t'i transmetojë pa aprovimin paraprak të Palës Kontraktuese që ka furnizuar informacionet, tek organet përgjegjëse për veprimtarinë hetimore dhe tek organet gjyqësore me qëllim ndjekjen dhe shtypjen e veprave penale. Në të gjitha rastet e tjera të transmetimit është i nevojshëm aprovim i Palës Kontraktuese që ka furnizuar informacionet.

b) Gjatë transmetimit të të dhënave, organi gjyqësor i Palës Kontraktuese kujdeset për korrektësinë dhe nivelin e përditësimit. Kurdoherë që mund të besohet se janë transmetuar të dhëna të pasakta, ose të dhëna të cilat nuk duhet të ishin komunikuar, apo të dhëna të transmetuara në mënyrë legjitime duhet që në një moment të caktuar të fshihen në përputhje me dispozitat e ligjit të Palës Kontraktuese që i ka komunikuar (dhënë), atëherë organi marrës informohet pa vonesë. Ky organ ka detyrimin të procedojë me korrigjimet e të dhënave në fjalë ose t'i fshijë ato. Nëse organi marrës ka arsye të besojë se të dhënat e komunikuar janë të pasakta ose duhen fshirë, bën me dije Palën Kontraktuese që i ka komunikuar.

c) Nëse të dhënat e komunikuar duhet të fshihen apo korrigjohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit të Palës Kontraktuese që i ka komunikuar, personi i interesuar duhet të disponojë të drejtën efektive të korrigjimit.

d) Organet gjyqësore të interesuara procedojnë me regjistrimin e transmetimit, dhe me marrjen e të dhënave të shkëmbyera.

e) Nëse kërkohet, organet gjyqësore që transmetojnë dhe marrin të dhënat, duhet të vënë në dispozicion të të interesuarit informacione lidhur me të dhënat e tij personale të transmetuara, si dhe mbi përdorimin që parashikohet të bëhet. Detyrimi për të ofruar informacione nuk ekziston më kur konsiderohet se interesi publik për mosdhënien e informacioneve është mbi interesin e personit të interesuar për t'i marrë. Për më tej, e drejta e të interesuarit për të marrë informacione lidhur me të dhënat personale të transmetuara rregullohet nga ligjet, nga rregulloret, dhe nga procedurat e brendshme të vendeve kontraktuese palë, në territorin e të cilave drejtohet kërkesa për informacion. Para se të merret vendimi lidhur me komunikimin e informacioneve, organi që transmeton të dhënat, duhet të ketë mundësinë të

shprehë mendimin e tij.

f) Sipas dispozitave të ligjit, të rregulloreve dhe procedurave të brendshme, Palët Kontraktuese janë përgjegjëse për dëmet e shkaktuara kundrejt personave, për rrjedhojë të përpunimit të të dhënave në Palën Kontraktuese të interesuar. Ato konsiderohen përgjegjëse atëherë kur dëmi është shkaktuar nga transmetimi i të dhënave të pasakta, ose nga një transmetim nga ana e organeve gjyqësore që është kryer në dhunim të dispozitave të konventës.

g) Të dhënat e transmetuara ruhen vetëm për një periudhë të nevojshme për qëllim të komunikimit të tyre. Pala Kontraktuese e interesuar, vlerëson në kohën e duhur nevojën për ruajtjen e të dhënave.

h) Në çdo rast, mbi të dhënat ushtrohet mbrojtje të paktën në nivelin e mbrojtjes që pala marrëse i jep të dhënave analoge.

i) Palët Kontraktuese kërkojnë marrjen e masave të duhura për të garantuar dhe respektuar këtë dispozitë me anë të kontrolleve të efektshme. Palët Kontraktuese mund të transferojnë të tilla detyra kontrolli edhe tek organet e brendshme mbikëqyrëse.

TITULLI VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23 **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit vijues pas marrjes së njoftimit të dytë nga të dy njoftimet me të cilat palët njoftojnë përfundimin e procedurave të brendshme përkatëse.

2. Kjo Marrëveshje mund të kundërshtohet me shkrim në çdo moment. Kundërshtimi merr efekt nga dita e parë e muajit të gjashtë pas ditës në të cilën Pala tjetër Kontraktuese do të marrë njoftimin përkatës.

3. Kjo Marrëveshje pushon së qeni në fuqi edhe pa kundërshtimin e përmendur në paragrafin e mësipërm, nga data në të cilën Konventa për Ndihmë Juridike në Fushën Penale dhe Konventa Europiane mbi Ekstradimet, nuk do të kenë më efekte ndërmjet Palëve Kontraktuese. Në prani të njëri-tjetrit, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar për këtë nga qeveritë përkatëse të tyre, firmosën këtë Marrëveshje.

LIGJ Nr.9872, datë 14.2.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5632, datë 25.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË MBI BASHKËPUNIMIN FINANCIAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë *në frymën e marrëdhënieve* miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar premtimit të ambasadës gjermane në Tiranë të datës 15 dhjetor 2004 dhe konsultimeve ndërqeveritare të datës 13 mars 2007 në Tiranë,

janë marrë vesh për sa më poshtë:

Neni 1

1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe/ose marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW – Frankfurt mbi Main), shumat e mëposhtme:

1. hua me vlerë prej deri në 4 000 000 eurosh gjithsej (me fjalë: katër milionë euro) për projektin “Programi i furnizimit me ujë të zonave rurale”, si dhe

2. një shumë financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në pikën 1, me vlerë deri në 1 000 000 euro gjithsej (me fjalë: një milion euro). Kur nga shqyrtimi përkatës u konstatua se projekti vlen për t'u mbështetur.

2) Nëse Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bien dakord, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3) Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shumat të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shumat të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

4) Shumat e financimit për masa shoqëruese sipas paragrafit 1 pika 2 do të kthehen në hua në rast se nuk përdoren masa të tilla.

Neni 2

1) Përdorimi i kontributit financiar të përmendur në nenin 1, kushtet nën të cilat vihen në dispozicion, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis KfW-së dhe marrësve të huave respektive të shumave të financimit, kontrata të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2) Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1, paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 do të zhvlehtësohen në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vitesh pas vitit të premtimit. Për shumat në fjalë ky afat përfundon më datë 31 dhjetor 2012.

3) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrësi, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro, duke plotësuar detyrimet e huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është vetë marrësi i shumës

së financimit, do të garantojë Kreditanstalt für Wiederaufbau premtime eventuale lidhur me shlyerjen që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportin e personave dhe mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që nuk rezulton nga dhënia e huasë dhe nga dhënia e shumës së financimit, si dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, në rast se nevojiten, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Nga huaja me vlerë prej 23 500 000 DM (me fjalë: njëzet e tre milionë e pesëqind mijë marka gjermane) baraz me 12 015 359, 21 euro (me fjalë: dy milionë e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë euro dhe njëzet e një cent) e parashikuar në marrëveshjen e datës 10 maj 2001 për bashkëpunimin financiar-projekti “Mbështetje për ekonominë nëpërmjet zgjerimit të infrastrukturës komunale Elbasan” do të zbritet dhe riprogramohet një shumë prej 3 500 000 euro (me fjalë: tre milionë e pesëqind mijë euro). Kjo shumë do të përdoret si shtesë për projektin “Programi i furnizimit me ujë të zonave rurale”, të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 pika 1.

Neni 6

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, që janë plotësuar kushtet brenda shtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është data e marrjes së njoftimit.

U firmos në Tiranë, më 28.12.2007 në dy ekzemplarë origjinalë, secili në gjuhën gjermane dhe gjuhën shqipe, të dy tekstet me të njëjtën vlerë autentike.

LIGJ

Nr.9874, datë 14.2.2008

PËR ANKANDIN PUBLIK

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për realizimin e shitjes publike nëpërmjet procedurës së ankandit nga autoriteti shitës dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të pjesëmarrësve në procedurën e ankandit.

2. Qëllime të këtij ligji janë:

- a) rritja e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e ankandit publik, të kryera nga autoritetet shitëse;
- b) nxitja e pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik;
- c) nxitja e konkurrencës ndërmjet blerësve;
- ç) sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e ankandit publik;
- d) sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparenca në procedurat e ankandit publik.

Neni 2

Parimet e zhvillimit të ankandit publik

Zhvillimi i procedurave të ankandëve publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë i pjesëmarrësve në procedurat e ankandit publik;
- b) transparenca në procedurat e ankandit publik;
- c) barazia në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve, që u ngarkohen pjesëmarrësve në procedurat e ankandit publik.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ankand publik” është procedura e shitjes, nëpërmjet së cilës përcaktohen të drejtat e pronësisë që transferohen në formën e ofertës publike, në bazë të çmimit më të lartë të ofruar.

2. “Autoritete shitëse” janë autoritetet publike, të cilat, në zbatim të këtij ligji, kanë të drejtë të shesin pronën publike nëpërmjet ankandit publik dhe të zbatojnë kontratat e tyre të shitjes. Këto autoritete janë:

- a) institucionet kushtetuese, institucionet e tjera qendrore, institucionet qendrore të pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore;
- b) çdo ent:
 - i) i themeluar për të ndjekur një interes të përgjithshëm dhe me karakter joekonomik apo tregtar;
 - ii) i cili ka personalitet juridik;

iii) i financuar kryesisht nga shteti, autoritetet rajonale apo vendore, ose nga ente të tjera publike apo i administruar prej tyre, ose me një bord administrativ, manaxherial apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve të tyre emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose vendore apo nga entet e tjera publike;

c) organizatat e formuara nga një ose disa nga këto autoritete apo nga një ose disa nga këto organe publike;

ç) çdo ent tjetër publik.

3. “Kandidatë blerës” janë të gjithë personat fizikë apo juridikë që kërkojnë të marrin pjesë me ofertën e tyre në procedurën e shitjes publike nëpërmjet ankandit publik.

4. “Ofertues” janë të gjithë personat fizikë apo juridikë që paraqesin ofertën e tyre në procedurën e shitjes publike nëpërmjet ankandit publik.

5. “Procedura përzgjedhëse të ankandit” janë procedurat e ndërmarra nga autoriteti shitës për përzgjedhjen e fituesve për kontratat publike të shitjes.

6. “Kontrata të shitjes publike” janë kontratat e lidhura ndërmjet një ose më shumë blerësve dhe autoritetit shitës, që kanë si objekt shitjen publike të çdo sendi me vlerë ekonomike, në përputhje me këtë ligj.

7. “Blerës” është ofertuesi që ka ofruar çmimin më të lartë dhe që likuidon menjëherë vlerën e ofruar.

8. “Procedurë e hapur” është ankandi, përmes të cilit çdo kandidat blerës i interesuar mund të dorëzojë ofertën e vet.

9. “Procedurë me përzgjedhje të blerësve” është ankandi, përmes të cilit vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti shitës mund të dorëzojnë oferta.

10. “Procedurë me negociim” është ankandi, përmes të cilit autoriteti shitës i përzgjedh vetë kandidatët blerës dhe negocion kushtet e kontratës me një ose më shumë prej tyre.

11. “Regjistër i ankandit publik” është regjistri i mbajtjes së të dhënave për fazën e përzgjedhjes dhe të shitjes me ankand, që mbahet nga autoriteti shitës dhe që në përfundim të procesit depozitohet në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Forma dhe mënyra e mbajtjes përcaktohen nga kjo agjenci.

12. “Agjencia e Prokurimit Publik” është institucioni që është ngritur dhe funksionon sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar;

13. “Avokati i Prokurimeve” është institucioni që është ngritur dhe funksionon sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

14. “Rregullat e ankandit publik” janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

15. “Dokumentet e ankandit publik” janë dokumentet, të cilat autoriteti shitës ua vë në dispozicion kandidatëve blerës dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave.

16. “Informacion” është dokumenti dhe informacioni për procedurat që, sipas kërkesës, i vihen në dispozicion çdo ofertuesi apo kandidati blerës, i cili kundërshton një ose më shumë vendime të autoritetit shitës, të marra gjatë procedurave të ankandit. Dhënia e informacionit mund të kufizohet deri në atë masë që nevojitet për të përmbushur detyrimet e fshehtësisë apo të masave të sigurisë.

17. “Shitje elektronike” është procesi që përfshin një mënyrë elektronike për paraqitjen e çmimeve mbi elemente të veçanta të ofertës dhe që kryhet pas vlerësimit paraprak të ofertave, duke i klasifikuar ato nëpërmjet metodave të vlerësimit automatik.

18. “Mënyrë elektronike” është përdorimi i pajisjeve elektronike për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave (përfshirë këtu edhe përpunimin dixhital) që transmetohen, jepen e merren përmes kabllave, radios, mjeteve optike ose çdo mjeti tjetër elektromagnetik.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për shitjen nëpërmjet ankandit publik:

- a) të kuotave të pjesëmarrjes në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar apo aksionet për shoqëritë anonime (pa ofertë publike) për kontributet në natyrë;
- b) të mallrave ushqimore të blera me shumicë me fondet e Buxhetit të Shtetit;
- c) të vlerave (mallrave) materiale të dala jashtë përdorimit;
- ç) të objekteve të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e ngarkuara me ligj;
- d) të objekteve të përcaktuara me ligj të veçantë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonomisë, autorizon shitjen nëpërmjet ankandit publik edhe për objekte të tjera, pronë publike.

3. Ky ligj nuk zbatohet për rastet e parashikuara në nenin 5 të këtij ligji dhe për ato që rregullohen me ligj tjetër.

Neni 5

Përjashtimet

Ky ligj nuk zbatohet për rastet e mëposhtme:

a) kur objekti i shitjes është një objekt i trashëgimisë kulturore me vlera historike, kombëtare, shkencore, kulturore, arkeologjike;

b) kur shitja e objektit publik rregullohet me akte të tjera ligjore;

c) në shitjen e monedhave prej ari, argjendi, platini;

ç) në shitjen e armëve, të teknikës, pajisjeve, municioneve, lëndëve eksplozive dhe të materialeve luftarake e të shërbimeve të lidhura me to, të hequra nga armatimi dhe përdorimi, që do të shiten për përdorim ushtarak;

d) kur autoriteti shitës rrezikon të botojë të dhëna, që mund të cenojnë interesat thelbësorë të sigurisë kombëtare;

dh) ky ligj nuk zbatohet për shitjet publike, të cilat kërkojnë masa të veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

e) në rast se ky ligj bie ndesh me një detyrim, që shteti ka në bazë të një marrëveshjeje me një ose më shumë shtete të tjera apo me një organizatë ndërkombëtare, që është ratifikuar me ligj, atëherë zbatohen dispozitat e marrëveshjes në fjalë. Në të gjitha rastet e tjera, procedurat e ankandit publik i nënshtrohen këtij ligji;

ë) procedura e ankandit publik nuk zbatohet në rastet kur objekt i shitjes publike janë ndihmat, kreditë për aq sa ato bien në kundërshtim me kushtet dhe marrëveshjet e miratuara me donatorët.

KREU II ORGANIZIMI I ANKANDIT PUBLIK

Neni 6 **Autoriteti shitës**

1. Autoriteti shitës është përgjegjës për realizimin e ankandeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Autoriteti shitës duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të ankandit, në mënyrë të tillë që të lejojë kontrollin e zbatimit të ligjit. Forma dhe përmbajtja e procesverbalit dhe dokumentacionit përcaktohen në rregullat e ankandit publik.

3. Autoriteti shitës duhet të plotësojë regjistrin e ankandeve publike për të gjitha procesverbalet për dokumentet e ankandit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, të cilin, pas përfundimit të procedurës, e dërgon pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

4. Autoriteti shitës, çdo 6 muaj, duhet të dorëzojë në Agjencinë e Prokurimit Publik një raport për veprimtaritë e tij të ankandit. Formatit dhe përmbajtja e këtij raporti përcaktohen në rregullat e ankandit.

5. Autoriteti shitës krijon njësi ankandi brenda strukturës së vet, detyrat e përgjegjësitë e së cilës përkufizohen në rregullat e ankandit publik.

Neni 7 **Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave të shitjes me ankand publik**

1. Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave të shitjes me ankand dhe shqyrtimi administrativ i ankesave ndaj tyre bëhen nga Agjencia e Prokurimit Publik.

2. Agjencia e Prokurimit Publik, në ushtrimin e funksioneve për ankandet, ka këto kompetenca:

a) u kërkon autoriteteve shitëse raportime periodike, një herë në 6 muaj, për ankandet publike të realizuara dhe zbatimin e procedurave të tyre;

b) verifikon zbatimin e procedurave të ankandeve publike, në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve shitëse të gjithë informacionin e nevojshëm;

c) i propozon autoritetit shitës marrjen e masave disiplinore dhe vendos gjoka nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë, në rastet kur vëren shkelje të procedurave të këtij ligji;

ç) bën shqyrtimin administrativ të ankesave të ofertuesve në lidhje me procedurat e shitjes me ankand publik;

d) vendos dhe shpall përjashtimin 1 deri në 3 vjet nga procedurat e ankandit publik të ofertuesve, të cilët gjatë një procedure shitjeje kanë depozituar dokumente false apo kanë deklaruar informacion të rremë;

dh) raporton një herë në 6 muaj pranë Këshillit të Ministrave për kontratat e shitjes, të realizuara me ankand publik.

Neni 8 **Mbrojtja e interesave ligjorë të kandidatëve blerës**

1. Të drejtat dhe interesat e ligjshëm të kandidatëve blerës nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të autoriteteve shitëse në fushën e ankandit publik mbrohen nga Avokati i Prokurimeve, nëpërmjet monitorimit dhe hetimit të procedurave administrative të ankandeve publike.

2. Avokati i Prokurimeve, në ushtrimin e funksioneve të tij, sipas këtij ligji, ka këto kompetenca:

a) shqyrton ankesat e paraqitura nga një individ ose grup individësh, person juridik, autoritet publik ose çdo kandidat blerës, për veprime joligjore e të parregullta ose për mungesë veprimi nga autoritetet shitëse në çdo fazë të ankandit publik;

b) fillon hetimin e procedurave administrative, kur vëren ose dyshon se ka pasur shkelje të këtij ligji;

c) në përfundim të hetimit të procedurave administrative informon të interesuarit dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për rezultatet e hetimit.

3. Në të gjitha rastet, Avokati i Prokurimeve njofton të interesuarit dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për veprimet e tij brenda 5 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

4. Gjatë një hetimi, Avokati i Prokurimeve ka të drejtë:
- a) të këqyrë në vend aktet dhe dokumentet që kanë lidhje me çështjen në hetim;
 - b) të kërkojë informacione e shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore apo vendore, të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen në hetim dhe të thërrasë të gjithë personat pa imunitet e të kërkojë ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta;
 - c) të rekomandojë ndryshimin e ligjit dhe të akteve të dala në zbatim të tij, kur vëren se përmbajtja e tyre krijon mundësi për shkelje të procedurave të ankandit publik.
 - ç) t'i propozojë drejtuesit të autoritetit kontraktor marrjen e masave disiplinore.

KREU III RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË ANKANDIT

Neni 9 **Mosdiskriminimi**

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që përbën diskriminim ndaj ose ndërmjet kandidatëve blerës apo ndaj kategorive të tyre.

Neni 10 **E drejta për informim**

1. Informacioni i administruar për çdo ankand publik, sipas këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, me kërkesë të tij, pasi është përcaktuar oferta fituese apo pasi procedurat e ankandit kanë përfunduar pa përcaktuar një fitues. Kërkesat për informacion mund të paraqiten në çdo çast dhe autoriteti shitës është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës.

2. Autoriteti shitës vë në dijeni sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit:

- a) çdo kandidat të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në ankand;
- b) çdo ofertues të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të ofertës së tij;
- c) çdo ofertues të suksesshëm, që ka paraqitur një ofertë të vlefshme, për karakteristikat dhe përparësitë e ofertës së përzgjedhur.

3. Pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen, autoriteti shitës mund të mos bëjë publike disa nga informacionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nëse një gjë e tillë vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave ose cenon interesin publik apo interesat ligjorë dhe ekonomikë të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë.

Neni 11 **Format e komunikimit**

1. I gjithë dokumentacioni, njoftimet, vendimet, informacionet dhe komunikimet e parashikuara në këtë ligj bëhen ose dokumentohen me shkrim.

2. Në disa raste autoriteti shitës mund të vendosë të komunikojë në formë elektronike. Mjetet e komunikimit elektronik dhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë jodiskriminuese, të disponueshme dhe të ndëroperueshme me produktet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të cilat përdoren gjerësisht. Rregullat dhe procedurat për këtë formë komunikimi përcaktohen në rregullat e ankandit publik.

3. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë, që të sigurojnë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje. Forma e përdorur për komunikimin, shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit duhet të garantojë se autoriteti shitës mund të shqyrtojë përmbajtjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor ligjor për dorëzimin e tyre, i përcaktuar nga ky ligj.

Neni 12 **Informacion për objektin e shitjes**

1. Identifikimi i objektit të shitjes bëhet nga autoriteti shitës që do të realizojë procedurën e shitjes me ankand. Autoriteti shitës përcakton karakteristikat e objektit që do të shitet, duke përshkruar atë sa më

saktë dhe në mënyrë të plotë, për të krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

2. Informacionet për objektin që do të shitet duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në ankandin publik.

3. Informacioni i autoritetit shitës duhet të përshkruajë qartë objektin që do të shitet me ankand publik, duke iu referuar aktit të pronësisë mbi objektin apo aktit ligjor të disponibilitetit të tij.

4. Objekti duhet të përshkruhet në përputhje me standardet e vlerësimit sipas sasisë, çmimit për njësi dhe çmimit në total, metodologjisë së përdorur për vlerësimin e objektit të shitjes, kur këto janë kryer sipas standardeve të caktuara kombëtare apo ndërkombëtare.

5. Objekti duhet të shoqërohet, kur është e nevojshme, edhe me genplane, planimetri të objektit, vizatime, modele, makete, mostra, fotografi, analiza kimike etj. Nga përshkrimi duhet të dalë gjendja funksionale e objektit të shitjes nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale.

Neni 13

Anulimi i ankandit

1. Autoriteti shitës lejohet që, në çdo kohë, të anulojë ankandin, për arsye të interesit publik, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës. Autoriteti shitës në asnjë rast nuk është i detyruar të shpallë fituesin për një ankand.

2. Autoriteti shitës nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve, që kanë paraqitur oferta, për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.

3. Autoriteti shitës, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, u komunikon të gjithë kandidatëve blerës ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar ankandin brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.

4. Autoriteti shitës boton njoftimin për anulimin e ankandit brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit për anulim.

Neni 14

Fshehtësia e procesit

Pa cenuar dispozitat e këtij ligji, autoriteti shitës nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga kandidatët blerës ose ofertuesit, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

Neni 15

Veprimet korruptive dhe konflikti i interesave

1. Autoriteti shitës refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrje në procedurën e shitjes me ankand publik nëse:

a) ofertuesi apo kandidati blerës i jep ose premton t'i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një zyrtari apo punonjësi një shpërblim në çfarëdolloj forme, mundësi punësimi ose mall, shërbim ose vlerë, si stimul për një akt, vendim apo procedurë, që ndërmerr autoriteti shitës për procedurat e ankandit;

b) ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit.

Refuzimi dhe arsyet për një veprim të tillë duhet të pasqyrohen në procesverbalet e procedurave të ankandit publik, sipas nenit 6 të këtij ligji dhe duhet t'i komunikohen, menjëherë dhe zyrtarisht, kandidatit ose ofertuesit në fjalë. Vendimi mund të ankimohet në rrugë gjyqësore.

2. Vendimet e marra nga autoriteti shitës, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, nuk pengojnë kallëzimin penal në organet përkatëse, kur aktet apo veprimet në fjalë përbëjnë vepër penale.

Neni 16

Metodat e përlllogaritjes së vlerës fillestare në ankandin publik

Përcaktimi i vlerës fillestare të një objekti ankandi bazohet në Vlerën Aktuale Monetare (VAM), çmimet e tregut, të dhënat e INSTAT-it apo të organeve të tjera shtetërore. Në vlerën fillestare përfshihen edhe detyrimet fiskale që lidhen me natyrën e objektit. Mënyra e përlllogaritjes së vlerës fillestare do të përcaktohet në rregullat e ankandit publik.

Neni 17

Procedurat standarde të ankandit

1. Autoriteti shitës shet pronën publike, sipas përcaktimeve në këtë ligj, nëpërmjet formave të mëposhtme të ankandit publik:

- a) procedurë e hapur;
- b) procedurë me përzgjedhje të blerësve;
- c) procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të ankandit.

2. Procedura e hapur mund të përdoret për të gjitha llojet e ankandeve.

3. Procedura me përzgjedhje të blerësve përdoret në shitjet publike kur është e domosdoshme të bëhet dallimi ndërmjet fazës së përzgjedhjes dhe fazës së përcaktimit të ofertës fituese. Dallimi ndërmjet procedurës së hapur dhe procedurës me përzgjedhje të blerësve bëhet në rregullat e ankandit.

4. Autoriteti shitës mund të përdorë, në raste të veçanta, procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të ankandit.

Neni 18

Procedura e hapur

1. Ankandet zhvillohen me procedurë të hapur, veç rasteve të parashikuara në nenet 19 e 20 të këtij ligji.

2. Në procedurën e hapur autoriteti shitës boton një njoftim, në përputhje me nenet 23 dhe 24 të këtij ligji, në të cilin jepet një përshkrim i objektit të shitjes.

3. Të gjithë ofertuesit e dorëzojnë ofertën e tyre, përkatësisht, ofertën ekonomike dhe provën për përmbushje të kriterëve përzgjedhëse, sipas kërkesave të neneve 29 e 30 të këtij ligji.

4. Pas mbarimit të afatit maksimal për paraqitjen e ofertave, të përcaktuar në njoftimin e ankandit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji, autoriteti shitës hap ofertat, verifikon kualifikimet apo mangësitë e ofertuesve, dokumentacionin, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 29 e 30 të këtij ligji dhe përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e çmimit më të lartë të ofruar.

Neni 19

Procedura me përzgjedhje të blerësve

1. Procedura me përzgjedhje të blerësve përdoret nga autoriteti shitës për të kryer një shitje, në rastet kur:

a) objekti i shitjes, për shkak të karakterit të tij shumë të ndërlikuar ose të veçantë, mund t'u ofrohet një numri të kufizuar blerësish;

b) për autoritetin shitës është më e leverdishme, fillimisht, të shqyrtojë kapacitetin dhe kualifikimet e kandidatëve blerës të interesuar dhe më pas të ftojë ata që kanë kualifikimet minimale specifike të caktuara të paraqesin ofertat.

2. Në procedurën e përzgjedhjes së blerësve, autoriteti shitës boton një njoftim, sipas nenit 23 të këtij ligji, i cili përmban:

- a) një përshkrim të objektit që do të shitet;
- b) një tregues të kriterëve përzgjedhëse, sipas nenit 29 të këtij ligji;
- c) një ftesë, për të shprehur interesin për pjesëmarrje në procedurën e ankandit.

3. Pas mbarimit të afatit kohor të shpallur për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji, autoriteti shitës përzgjedh kandidatët blerës, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji.

4. Më pas autoriteti shitës u dërgon ftesën për ofertë kandidatëve të përzgjedhur, në përputhje me nenin 25 të këtij ligji, duke u kërkuar atyre të paraqesin ofertat ose dokumentacionin e kërkuar në fazën e dytë.

5. Pas mbarimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, autoriteti shitës hap ofertat dhe përcakton fituesin, në mbështetje të kriterit të çmimit më të lartë të ofruar.

Procedura me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit

1. Autoriteti shitës mund të përdorë procedurën me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të ankandit kur:

a) janë zhvilluar dy procedura të hapura ose me përzgjedhje të blerësve dhe në përfundim të gjitha ofertat janë të pavlefshme apo nuk përmbushin kërkesat e dispozitave ligjore në fuqi dhe për sa kohë që objektit të shitjes nuk i është bërë ndonjë ndryshim thelbësor, sipas përcaktimeve të bëra në rregullat e ankandit publik;

b) natyra e objektit të shitjes apo rreziku i lidhur me to nuk lejon përcaktimin paraprak të çmimit të plotë dhe, në veçanti, në rastet:

i) e shitjes së mallrave me shumicë, të cilave u skadon afati i përdorimit;

ii) e shitjes së mallrave (fruta, perime) që prishen.

2. Autoriteti shitës mund të përdorë procedurën me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit, me kusht që të respektohen parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe transparencës.

3. Autoriteti shitës negocion me ofertuesit, për t'i përshtatur ofertat e tyre me kërkesat e përcaktuara në njoftim, për të përzgjedhur ofertën më të mirë.

4. Autoriteti shitës duhet të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit gjatë zhvillimit të dialogut individual me secilin prej tyre. Asnjë informacion diskriminues apo që mund t'u sjellë përparësi disa ofertuesve mbi të tjerët nuk duhet të bëhet i njohur.

5. Autoriteti shitës mund të marrë masa që procedura me negocim të kryhet në faza të ndryshme, duke zbatuar kriteret e vlerësimit, të shpallura në njoftim apo në specifikime, për reduktimin e numrit të ofertave që duhen negociuar.

Kur ankandi zhvillohet në faza të ndryshme, duhet të shpallet në njoftim ose në specifikime.

KREU IV

ANKANDI ELEKTRONIK

Rregullat e zbatueshme të komunikimeve elektronike

1. Pa cenuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit dhe dispozitat e nenit 11 të këtij ligji, për marrjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik, zbatohen rregullat për komunikimin elektronik, si më poshtë:

a) informacionet, që lidhen me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, janë në dispozicion të palëve të interesuara. Mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e ankandit publik dhe me legjislacionin përkatës;

b) ofertat elektronike duhet të shoqërohen nga nënshkrimi elektronik, sipas standardeve ndërkombëtare;

c) përpara përfundimit të afatit kohor të përcaktuar për dorëzimin e ofertave ose të kërkesave për pjesëmarrje, kandidatët blerës ose ofertuesit marrin përsipër të paraqesin dokumentet, certifikatat dhe dëshmitë e përmendura në nenin 29 të këtij ligji, nëse këto të fundit nuk ekzistojnë në format elektronik.

2. Pa paragjykuar parimin e mosdiskriminimit dhe detyrimet e nenit 11 të këtij ligji, rregullat e mëposhtme zbatohen për nënshkrimin në formë elektronike për gjithçka që ka të bëjë me paraqitjen dhe pranimin e ofertave dhe dokumenteve të lidhura me to:

a) kur ligji i ankandit parashikon nënshkrimin nga ana e një personi, kjo kërkesë quhet e përmbushur për të gjitha dokumentet e ankandit, nëse nënshkrimi elektronik i përdorur është i besueshëm dhe i përshtatshëm për qëllimet, për të cilat dokumenti elektronik është krijuar ose është komunikuar, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat konkrete ose në përputhje me ligjet dhe rregullat me aplikim të përgjithshëm për tregtinë në formë elektronike;

b) nënshkrimi në formë elektronike është i besueshëm dhe në përputhje me këtë ligj nëse:

i) është i dukshëm dhe brenda materialit për të cilin paraqitet, i lidhur logjikisht me personin që e nënshkruan dhe jo me ndonjë person tjetër;

ii) dokumentet origjinale ose të dhënat e përdorura për nënshkrimin elektronik në çastin e nënshkrimit kanë qenë nën kontrollin ekskluziv të personit që nënshkruan dhe mbeten të tilla gjatë procesit të ankandit dhe për një kohë të arsyeshme edhe pas përfundimit të këtij procesi, siç parashikohet nga legjislacioni ose rregullat e ankandit publik;

iii) çdo ndryshim në nënshkrimin elektronik, i bërë pas kohës së nënshkrimit, mund të dallohet me një kujdes të arsyeshëm;

iv) asnjë nga parashikimet e këtij neni nuk ka për qëllim të kufizojë mundësinë e çdo kandidati blerës që, në çdo mënyrë të lejuar nga legjislacioni në fuqi, të provojë apo të kundërshtojë besueshmërinë e nënshkrimit elektronik.

Neni 22 **Ankandi elektronik**

Për të kryer një procedurë elektronike ankandi, autoriteti shitës ndjek rregullat e ankandit, të përshkruara në rregullat e ankandit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me parimet e përmendura në nenin 2 të këtij ligji dhe me standardet ndërkombëtare dhe europiane.

KREU V **ZHVILLIMI I PROCEDURAVE**

Neni 23 **Njoftimet**

1. Autoriteti shitës, kur zhvillon ankand me procedurë të hapur, me përzgjedhje të blerësit ose me negociim, në përputhje me nenet 18, 19 e 20 të këtij ligji, bën njoftimin publik për kryerjen e llojit përkatës të ankandit publik.

2. Njoftimet për ankandet botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe, sipas rastit, në një gazetë të huaj me shpërndarje në Europë, sipas përcaktimit në rregullat e ankandit publik.

3. Të gjitha njoftimet e ankandëve shpallen në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Neni 24 **Përmbajtja e njoftimeve**

1. Njoftimet që botohen, duhet të përfshijnë të gjitha informacionet, që u lejojnë kandidatëve të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e ankandit.

2. Në njoftim duhet të përcaktohen edhe vendi, adresa dhe afati i fundit kohor, ku e kur do të dërgohen ofertat, si dhe gjuha ose gjuhët, në të cilat duhet të hartohen ofertat. Gjithashtu duhet të përcaktohen edhe mënyra dhe kushtet për marrjen e dokumenteve të ankandit, siç parashikohet në nenin 26 të këtij ligji.

3. Përmbajtja e njoftimeve standarde përcaktohet në rregullat e ankandit publik.

Neni 25 **Ftesa për ofertë**

1. Autoriteti shitës fton, nëpërmjet një komunikimi me shkrim, njëherësh, të gjithë kandidatët blerës, për të dorëzuar ofertat e tyre në procedurën e përzgjedhjes së blerësve dhe në procedurat me negociim, me njoftim të objektit të ankandit, sipas neneve 19 e 20 të këtij ligji.

2. Ftesa për kandidatët përfshin edhe:

a) një kopje të dokumenteve të ankandit dhe çdo dokument tjetër mbështetës;

b) një referencë për të pasur akses në dokumentet e ankandit publik dhe në dokumentet e tjera, të përcaktuara më sipër me rrugë elektronike.

3. Modelet e ftesës për pjesëmarrje në ankandin publik për negociim përshkruhen në rregullat e ankandit. Ftesa, në çdo rast, duhet të përmbajë të paktën:

a) një referencë për njoftimin e ankandit që botohet;

b) të dhëna për vendin dhe afatin e fundit kohor të paraqitjes së ofertave, si dhe gjuhën ose gjuhët, në të cilat duhet të hartohet oferta;

c) informacion për çdo dokument shtesë që duhet dorëzuar ose në mbështetje të deklaratave të ofertuesve, në përputhje me nenet 29 dhe 30 të këtij ligji, ose për të plotësuar informacionin e përmendur në këto nene.

4. Autoriteti shitës, kur përdor procedurën me përzgjedhje të blerësve dhe procedurën me negociim,

nuk mund ta kufizojë numrin e kandidatëve që ftohen për të paraqitur ofertën. Për procedurën me përzgjedhje të blerësve, numri minimal i kandidatëve të ftuar duhet të jetë jo më pak se 5, ndërsa për procedurën me negociim jo më pak se 3 kandidatë. Kur numri i kandidatëve që kanë shprehur interes është më i vogël se minimumi i përcaktuar, atëherë autoriteti shitës mund të vazhdojë procedurën e ankandit vetëm kur janë të paktën 2 kandidatë. Në njoftimin për ankand, autoriteti shitës duhet të përcaktojë kriteret objektive, jo diskriminuese, rregullat që do të zbatohen, si dhe numrin minimal të kandidatëve që do të ftohen.

Neni 26

Dokumentet e ankandit

1. Autoriteti shitës, në hartimin e dokumenteve të ankandit, përdor dokumentet standarde, të përcaktuara në rregullat e ankandit.

2. Në procedurën e hapur, autoriteti shitës i dorëzon kandidatëve blerës, pas kërkesës së tyre, dokumentet e ankandit kundrejt një pagese të përcaktuar në njoftimin për ankand dhe të llogaritur sipas mënyrës së përcaktuar në rregullat e ankandit. Dokumentacioni i plotë i ankandit vihet në dispozicion falas në rrugë elektronike.

3. Në procedurën me përzgjedhje të blerësve dhe në procedurën me negociim dokumentet e ankandit janë të përfshira në ftesën për ofertë ose për negociim. Ato duhet të jenë të vlefshme edhe në formë elektronike dhe duhet të përfshijnë në ftesë të gjitha të dhënat për shkarkimin e tyre me kompjuter.

4. Në çdo rast emrat dhe numri i kandidatëve, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të ankandit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.

Neni 27

Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e ankandit

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për objektin që do të shitet me ankand publik nga autoriteti shitës, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të ankandit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'u komunikojë sqarimin përkatës të gjithë kandidatëve të tjerë, që kanë tërhequr dokumentet e ankandit. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Agjencinë e Prokurimit Publik.

2. Autoriteti shitës, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave të ankandit dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një kandidat, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e ankandit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve blerës, që kanë tërhequr dokumentet e ankandit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. Në çdo rast, autoriteti shitës e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 5 ditë.

3. Autoriteti shitës, gjatë takimit me kandidatët blerës, duhet të mbajë procesverbal, ku përfshihen edhe kërkesat e dorëzuara gjatë takimit për sqarime për dokumentet e ankandit, si dhe përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, por, në çdo rast, pa identifikuar burimet e tyre.

Neni 28

Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave dhe të ofertave për pjesëmarrje

1. Autoriteti shitës, për përcaktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave të ankandit dhe të kërkesave për pjesëmarrje, duhet të mbajë parasysh kompleksitetin e objektit të ankandit dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar kufijtë kohorë minimalë, të përcaktuar në këtë nen dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Afatet kohore në këtë ligj jepen në ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur ka specifikime të tjera.

2. Në procedurat e hapura të ankandit publik afati për paraqitjen e ofertave të ankandit është jo më pak se 20 ditë nga data në të cilën është botuar njoftimi i ankandit.

3. Në procedurën e kufizuar, afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 10 ditë nga data, në të cilën është botuar njoftimi i ankandit dhe afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës

është 10 ditë nga data, në të cilën është dërguar ftesa për ofertë te kandidatët.

4. Në procedurën me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit, afati kohor minimal për dorëzimin e ofertave është 10 ditë nga data, në të cilën është botuar njoftimi i ankandit.

Neni 29

Kriteret dhe kushtet e kualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve

1. Autoriteti shitës kualifikon në procedurat e ankandit çdo kandidat ose ofertues vetëm kur paraqet:

- a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet standarde të ankandit;
- b) vendimin e gjykatës për fitimin e personalitetit juridik;
- c) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- ç) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.

2. Autoriteti shitës, kur kërkohet informacion për ofertuesin rezident në një shtet të huaj, mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve përkatëse.

Neni 30

Skualifikimi i ofertuesve

1. Autoriteti shitës skualifikon në çdo kohë kandidatët ose ofertuesit, që paraqesin të dhëna të rreme ose një dokument të falsifikuar, për qëllime kualifikimi, gjatë një procedure ankandi. Autoriteti shitës në këtë rast i kërkon Agjencisë së Prokurimit Publik përjashtimin nga ankandet publike të ofertuesit që ka përdorur këto të dhëna apo dokumente.

2. Autoriteti shitës skualifikon çdo kandidat apo ofertues, ndaj të cilit është marrë vendimi i përjashtimit nga procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit përkatës.

Neni 31

Paraqitja dhe pranimi i ofertave

1. Autoriteti shitës përcakton vendin, datën dhe orën e paraqitjes së ofertave.

2. Kur autoriteti shitës jep sqarime apo bën ndryshime në dokumentet e ankandit, vepron në përputhje me nenin 27 të këtij ligji.

3. Vendimi për shtyrje të afatit përfundimtar u njoftohet menjëherë të gjithë kandidatëve blerës, që kanë tërhequr dokumentet.

4. Paraqitja e ofertave bëhet si më poshtë:

a) ofertat dorëzohen me shkrim, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf, me përjashtim të rasteve të përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike;

b) pa prekur të drejtën e kandidatit blerës, për të dorëzuar ofertat në formën e përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike, oferta dorëzohet edhe në ndonjë formë tjetër, të përcaktuar në njoftimin e ankandit apo në ftesën për ofertë, e cila siguron një shkallë të ngjashme origjinaliteti, sigurie dhe konfidencialiteti, përfshirë edhe rrugët elektronike;

c) autoriteti shitës, sipas kërkesës, pajis ofertuesit me një dëshmi, ku shënohen data dhe ora e pranimi të ofertës.

5. Ofertat e paraqitura pas mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së tyre u kthehen të pahapura ofertuesve, që i kanë paraqitur ato.

Neni 32

Sigurimi i ofertës

1. Autoriteti shitës u kërkon të gjithë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas rregullave të ankandit. Për sigurimin e ofertës zbatohen disa kushte:

a) vlera e sigurimit duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e objektit të ankandit;

b) autoriteti shitës duhet të specifikojë në dokumentet e ankandit çdo kërkesë për natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës. Këto kërkesa nuk duhet të lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me sjelljen e kandidatit blerës që dorëzon një ofertë, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

i) tërheqjes ose ndryshimit të ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para

- afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e ankandit;
- ii) refuzimit për nënshkrimin e kontratës, kur autoriteti shitës e kërkon një gjë të tillë;
 - iii) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e ankandit.
2. Autoriteti shitës nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ankandit dhe e kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ankandit, nëse:
- a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;
 - b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e ankandit;
 - c) janë anuluar procedurat e ankandit pa shpallur fitues.

Neni 33

Vlefshmëria, modifikimi dhe tërheqja e ofertave

1. Ofertat janë të vlefshme gjatë periudhës kohore të specifikuar në dokumentet e ankandit.
2. Autoriteti shitës, përpara përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertave, mund t'u kërkojë ofertuesve të zgjasin këtë periudhë për një afat të caktuar. Në këtë rast:
 - a) ofertuesi mund të refuzojë kërkesën, pa humbur sigurimin e ofertës dhe vlefshmëria e ofertës së tij përfundon me mbarimin e periudhës fillestare të vlefshmërisë;
 - b) kur ofertuesi pranon zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë, me të zgjatet edhe sigurimi i ofertës apo paraqitet një sigurim i ri oferte, që mbulon periudhën e zgjatur të vlefshmërisë. Ofertuesi, që nuk zgjat periudhën e sigurimit të ofertës, ose që nuk paraqet një sigurim të ri oferte, vlerësohet se e ka refuzuar kërkesën për zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Neni 34

Ndalimi i modifikimit të ofertave

1. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim për ofertën ndërmjet autoritetit shitës dhe ofertuesit, në përputhje me pikën 1 të nenit 36 të këtij ligji.
2. Autoriteti shitës nuk ka të drejtë t'u kërkojë ofertuesve të ndërmarrin përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e ankandit, apo të ndryshojnë vlerën e ofertës ose ta modifikojnë në çfarëdolloj mënyre atë.
3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e nenit 20 të këtij ligji.

Neni 35

Hapja e ofertave

1. Autoriteti shitës i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e ankandit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuara në dokumentet e ankandit.
2. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave.
3. Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kërkuar nga autoriteti shitës, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së ankandit.
4. Procesverbali duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesit që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.

Neni 36

Shqyrtimi i ofertave

1. Autoriteti shitës, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre për

shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenin 20 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti shitës, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti shitës njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

3. Autoriteti shitës, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson se oferta është e vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e ankandit dhe në dokumentet e ankandit.

4. Autoriteti shitës vlerëson se një ofertë është vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e ankandit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj. Devijimet e kësaj natyre përcaktohen në rregullat e ankandit.

5. Autoriteti shitës nuk e pranon një ofertë:

- a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar;
- b) kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, të bërë sipas pikës 2 të këtij neni;
- c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e ankandit;
- ç) në rastet e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 37

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti shitës vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e ankandit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e ankandit.

2. Ofertat renditen duke filluar me çmimet më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin fillestar minimal të shitjes.

3. Autoriteti shitës përcakton ofertën më të mirë, pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

4. Autoriteti shitës shpall fitues ofertuesin, oferta e të cilit përmbush kriteret kualifikuese dhe ka vlerën më të lartë.

Neni 38

Administrimi i informacionit në proces

1. Pas hapjes së ofertave, pa cenuar detyrimet e përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin e ofertave dhe rekomandimet për ofertën fituese nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces, derisa të nënshkruhet kontrata.

2. Pas hapjes së ofertave dhe deri në shpalljen e ofertës fituese, asnjë ofertues nuk ka të drejtë të komunikojë me autoritetin shitës ose të përpiqet, në çfarëdo mënyre, për të ndikuar në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, përveç rasteve të parashikuara në ligj.

Neni 39

Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës

1. Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 37 të këtij ligji.

2. Brenda 10 ditëve nga njoftimi i fituesit, autoriteti shitës dërgon një njoftim në Agjencinë e Prokurimit Publik, i cili botohet në Buletin e Njoftimeve Publike.

Njoftimi përmban së paku këtë informacion:

- a) emrat e ofertuesve pjesëmarrës;
- b) vlerat e ofertave;
- c) emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit;
- ç) emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe vlerën e ofruar prej tij.

3. Autoriteti shitës dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë kontratën brenda 10 ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike. Kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e ankandit ose në dokumentet e ankandit.

4. Kontrata hyn në fuqi kur nënshkruhet nga ofertuesi fitues dhe nga autoriteti shitës.

5. Kur ofertuesi fitues nuk arrin të nënshkruajë kontratën ose nuk bën sigurimin e kontratës, nëse një gjë e tillë kërkohet, autoriteti shitës bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertuesve që kanë mbetur, nëse diferenca ndërmjet ofertës së klasifikuar në vend të parë dhe asaj të klasifikuar në vend të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës. Kjo nuk cenon të drejtën e autoritetit shitës, sipas nenit 13 të këtij ligji, për të refuzuar të gjitha ofertat e mbetura dhe për të anuluar procedurën e ankandit. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni, i dërgohet ofertuesit, oferta e të cilit është përzgjedhur sipas kësaj pike.

6. Kontrata e lidhur para përfundimit të afatit të njoftimit të klasifikimit apo para përfundimit të shqyrtimit administrativ, sipas kreut VII të këtij ligji, është absolutisht e pavlefshme.

KREU VI ZBATIMI I KONTRATËS

Neni 40

Kushtet për zbatimin e kontratës

1. Autoriteti shitës mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për atë kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e ankandit ose në dokumentet e ankandit.

2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës.

Neni 41

Rregullat që zbatohen për kontratën

1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e ankandit dhe në ofertën fituese.

2. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, duhet të përmbushen në mirëbesim nga palët.

3. Pa cenuar dispozitat e këtij ligji dhe ndonjë dispozitë tjetër të zbatueshme nga autoriteti shitës, kontratat e ankandit rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil.

KREU VII PROCEDURAT E RISHIKIMIT ADMINISTRATIV

Neni 42

Procedura e ankimit

1. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të ankandit, kur gjykon se një vendim i autoritetit shitës është marrë në kundërshtim me këtë ligj apo me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Ankesa i paraqitet me shkrim autoritetit shitës brenda 5 ditëve pune nga data kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti shitës pezullon vazhdimin e procedurës së ankandit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.

4. Autoriteti shitës shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 5 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'i njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

5. Nëse autoriteti shitës nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Agjencinë e Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti shitës, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti shitës. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet edhe autoritetit shitës.

6. Ankesa në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes. Elementet e

mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Agjencia e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, me Kodin e Procedurave Administrative dhe me rregullat e ankandit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme.

7. Me marrjen e ankesës me shkrim të ankimuesit, autoriteti shitës pezullon procedurat e ankandit, me përjashtim të rasteve kur Agjencia e Prokurimit Publik vendos ndryshe, në përputhje me pikën 2 të nenit 43 të këtij ligji.

8. Me marrjen e ankesës me shkrim të ankimuesit, Agjencia e Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim brenda 5 ditëve. Kur për shqyrtimin e ankesës kërkohet informacion nga autoriteti shitës, agjencia përgjigjet me shkrim, sipas përcaktimit në rregullat e ankandit publik, por jo më vonë se 20 ditë.

Neni 43

Të drejtat e Agjencisë së Prokurimit Publik

1. Me marrjen e ankesës me shkrim, Agjencia e Prokurimit Publik duhet të sigurohet që autoriteti shitës e ka pezulluar procedurën e ankandit. Pas një shqyrtimi paraprak të ankesës, Agjencia e Prokurimit Publik vendos nëse do të lëshojë ose jo një urdhër të ndërmjetëm, në përputhje me pikën 2 të këtij neni dhe vë në dijeni për këtë edhe autoritetin shitës.

2. Agjencia e Prokurimit Publik, në çdo kohë, pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, mund ta lejojë autoritetin shitës, me anë të një urdhri të ndërmjetëm, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e ankandit, nëse:

a) ka të dhëna se ankimuesi nuk do të ketë sukses me ankesën;

b) pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin shitës ose ofertuesit.

3. Agjencia e Prokurimit Publik mund të fillojë një procedurë hetimi administrativ, kur vërehet se ka pasur shkelje të këtij ligji.

4. Gjatë hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik ka të gjitha kompetencat e parashikuara nga ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 44

Ankimi në gjykatë

1. Kundër vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik ankuesi ka të drejtë që nga njoftimi i vendimit apo plotësimi i afatit të caktuar, sipas nenit 42 të këtij ligji, kur kjo agjenci nuk ka shqyrtuar ankimin, të bëjë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Gjykata kryen shqyrtimin gjyqësor, sipas procedurës dhe brenda afateve të caktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, kreu II “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

2. Shqyrtimi i këtij ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat e ankandit, të lidhjes së kontratës së shitjes publike ose ekzekutimin e detyrimeve, sipas kontratës së shitjes nga palët respektive.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 45

Rregullat e ankandit

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për miratimin e rregullave të ankandit publik dhe për zbatimin e tyre.

Neni 46

Kontratat e shitjes që janë nënshkruar

Ky ligj nuk zbatohet për procedurat e ankandeve publike, të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 47
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5634, datë 25.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 27.2.2008
 Doli nga shtypi më 27.2.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2008

Çmimi 32 lekë